REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr._____prot Datë më, __/__/2026

SHPALLJE PËR SHËRBIMIN VULLNETAR NË SEKTORIN E MZSH-së,

BASHKIA LUSHNJE

Në zbatim të Ligjit Nr. 152, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Ligji 45/ 2016 "Për Vullnetarizmin", VKB Nr.103, datë 30.11.2022 "Për ngritje e shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi" pranë Bashkia Lushnje dhe Ligji Nr. 45/2019 " Për Mbrojtjen Civile".

Në kuadër të përmbushjes së objektivave ligjore vullnetarizmi konsiderohet si një nga konponentët me vital të sistemit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi. Promovimi i vullnetarizmit në strukturat e shërbimit të MZSH-së është jashtëzakonisht i rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve për grupet zjarrëfikëse që operojnë në territorin e Bashkisë Lushnje .

Ekipet vullnetare varen nga drejtuesi i shërbimit zjarrëfikës dhe mund të operojnë çdo ditë të vitit, në shpëtimin e jetes,gjësë së gjallë,pronës,mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme fatkeqësi natyrore si dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Shërbimi vullnetarë për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi është pjesë e sektorit të MZSH-së Lushnje dhe ka një strukturë prej 20 vullnetarësh.

Vullnetaret mund të jenë të gjithë qytetarët të cilët përmbushin kushtet dhe kriteret sipas Ligjit nr. 45/2016 "Për Vullnetarizmin".

Kohëzgjatja ditore e vullnetarizmit është jo më shumë se 5 orë në ditë dhe jo më shumë se 25 orë në javë.

Uniforma e vullnetarit është ngjyrë jeshile pa grada dhe ka një simbol dalluse në krahun e majtë (miratuar me VKB-në nr.103, datë 30.11.2022).

Ofruesi i vullnetarizmit mund të jetë person fizik/juridik vendas ose i huaj një organizatë jo fitimprurese, organ publik ose bashkësi fetare.

KUSHTET DHE KRITERET

-Të jetë në gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyrat;

-Të mos jetë i/e dënuar me vendim të forcës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

-Fotokopje e kartës së identitetit;

-Çertifikatë familjare;

-Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike;

-Dëshmi penaliteti;

Dokumentat të dorëzohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore brenda datës 15.05.2026.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Erisa Qalliu